



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Mbledhja nr. 41

Prishtinë, më 08.6.2016, ora: 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti, Sadri Ferati, Xhevahire Izmaqi, Alma Lama, Shqipe Pantina dhe Jelena Bontiq.

Munguan: Kujtim Paçaku, Pal Lekaj dhe Zafir Berisha.

Në mbledhje morën pjesë: përfaqësuesit e OSBE-së, NDI-së, KDI-së dhe Radio Dukagjini.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Drita Morina dhe Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Diskutim rreth planit të veprimit të grupeve punuese për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve, sipas planit të punës së Komisionit;**
- 3. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Diskutim rreth planit të veprimit të grupeve punuese për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve, sipas planit të punës së Komisionit

Zenun Pajaziti, kërkoi nga kryesuesit e secilit grup punues (anëtarë të Komisionit), të raportojnë për punën lidhur me zbatimin ligjeve, që kanë pasur të monitorojnë.

Sadri Ferati, kryesues i grupit punues për monitorimin e Ligjit për kufijtë administrativ të komunave, tha se grupi punues ka ndërprerë punën, për arsye se në grup kanë mbetur vetëm dy anëtarë, në mungesë të anëtarëve të grupit punues nga opozita. Grupi punues tani ka paraparë një vizitë në Komunën e Gjilanit dhe të Novobërdës, meqë vetëm në dy pika mund të diskutohet për ligjin, por që sipas informacioneve paraprake, ka një diskutim në mes të dy komunave, Gjilanit dhe Novobërdës për disa ndryshime, të ashtuquajtura të vullnetshme, si dhe të ftohen në takim kryetari i Komunës së Gjilanit, Novobërdës dhe Mitrovicës.

Xhevahire Izmaku, kryesuese e grupit punues për monitorimin e Ligjit për administratën shtetërore, njoftoi Komisionin për vizitat që ka pasur grupi punues në Ministrinë e Administratës Publike, në ZKM dhe në Agjencinë e Statistikave të Kosovës.

Ajo propozoi, që në vizitën në Komunën e Gjilanit dhe Novobërdës, pjesë diskutimi të inkorporohet edhe monitorimi i Ligjit për administratën shtetërore.

Shqipe Pantina, kryesuese e grupit punues për monitorimin e Ligjit për OJQ-të, rreth punës së grupit punues, ajo kërkoi kohë për të vlerësuar se a ka nevojë për një monitorim të mëtejshëm apo të përfundohet me raportin.

Zenun Pajaziti, kërkoi nga kryesuesit e grupeve punues, që deri në fund të muajit korrik, të përgatisin raportet e punës lidhur me monitorimin e ligjeve.

Ai propozoi që takimi me kryetarët e komunave të lartcekura të organizohet si tryezë dhe të njoftohen të gjithë kryetarët e komunave, nëse kanë interesim të marrin pjesë në tryezë.

Gjithashtu, ia dha fjalën përfaqësuesit të NDI-së, të sqarojë para Komisionit rekomandimin që kishte për Komisionin.

Shefki Kastrati, përfaqësuesi i NDI-së, njoftoi Komisionin se NDI-ja, në kuadër të fushëveprimit të tyre që kanë për mbështetje të komisioneve parlamentare, kanë hartuar një analizë buxhetore, e cila do t'i shërbejë Komisionit si informatë për shpenzimet buxhetore, prioritetet, realizimet buxhetore, etj., për rastet kur Komisioni shqyrton raportin e shpenzimeve të institucionit përkatës.

3. Të ndryshme

Alma Lama, kërkoi që të ftohet në Komision për raportim, Bordi i RTK-së, lidhur me ankesën e një kandidati të komunitetit serb, i cili nuk ishte zgjedhur për drejtor të RTK2 dhe me përzgjedhjen e kundërkandidatit nga komuniteti i njëjtë, Bordi dhe menaxhmenti kanë bërë shkelje ligjore.

Ajo, gjithashtu, kërkoi sqarim lidhur me artikullin e botuar në media të një anëtari të Bordit të RTK-së, i cili kishte dëshmuar se ankesat për parregullsitë në RTK i kishte adresuar dhe protokolluar në zyrat e Kuvendit dhe për të cilat ajo nuk ishte njoftuar.

Kërkoi që çdo ftesë për udhëtim të anëtarëve të Komisionit, të shqyrtohet paraprakisht në Komision. Në këtë kontekst, ajo pyeti se pse nuk ishte e njoftuar për një ftesë që Ministria i kishte bërë Komisionit për një udhëtim në Slloveni.

Zenun Pajaziti,u përgjigj se ajo ka qenë një vizitë personale e ministrit, i cili ka propozuar që edhe Komisioni të bashkëngjitet në vizitë, Komisioni nuk e ka parë të arsyeshme të udhëtojë e të krijojë shpenzime.

Ndërsa, rreth ankesës së kandidatit për drejtor të RTK-2, i cili konsideron se i është bërë e padrejtë nga Bordi, Komisioni vendosi të kërkojë përgjigje me shkrim nga Bordi i RTK-së, lidhur me procedurat e rekrutimit të kandidatëve për drejtor të RTK2.

Konstatim: Komisioni vendosi për çështjet si në vijim:

Vizitë në Komunën e Gjilanit, Mitrovicës dhe Novobërdës;

Tryezë me kryetarët e komunave;

Tryezë për Ligjin për vetëqeverisje lokale dhe financimin e komunave;

Takim me ish- punëtorët e RTP-së;

Tryezë për shqyrtimin e raporteve financiare të institucioneve që bien në fushëveprimin e Komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën: 12:15.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Zenun Pajaziti